



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM
K.P.P. 427/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-48682-02-16-2018, me objekt “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 134.814.264 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Brendshme.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA dhe bashkimit të operatorëve ekonomike “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA
Tiranë, Kashar, Rruga Dytësore Tiranë – Durrës, brenda Tregut Agro Ushqimor, Km 1, ZK. 2679, RH. 52/8 vol.20, fq. 136, Tiranë

“Sori - AL” sh.p.k.
Rruga “Beqir Luga”, Pallati nr.3, Shk. 1/1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Brendshme
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

Public Health Sector

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.02.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-48682-02-16-2018, me objekt “*Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 134.814.264 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 15.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Nika” sh.p.k.
& ”Dajti Park 2007” sh.p.k. 108.636.691 lekë, kualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Alar Food & Service” sh.p.k.
& ”Serenissima Ristorazione” SPA 113.267.057,65 lekë, kualifikuar
3. “Sori - Al” sh.p.k. 133.680.083,68 lekë, kualifikuar
4. “Silver” sh.p.k. 0 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 29.03.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & ”Serenissima Ristorazione” SPA” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.3.1. Referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimes në datën 04.04.2018 dhe në datën 05.04.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]

Bazuar ne ligjin e prokurimit publik neni 63 si dhe Kodit te Procedurave Administrative ankimojme kualifikim e kompanise se kualifikuar ne vend te pare “Nika” apo bashkimit te O.E. NIKA & SILVER per arsyet e meposhtme:

Ne DST eshte kerkuar:

3.3 Kapaciteti teknik:

10. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguar për periudhën janar 2017 – dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- *Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën janar 2017 – dhjetor 2017.*
- *Listëpagesat (E-Sig 025) te vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 dhjetor 2017.*

Duke u nisur nga kjo kerkese ne DST te procedures objekt ankese na rezulton se kompania NIKA ne tatime ka te deklaruar nje mesatare prej 85 personash per te ushtruar veprimtarine e kompanise sipas objektit i cili pershin veprimtari ne ndertim, ne pyllzime dhe mbreshtim pyjesh, punime mermeri. transport nderkombetar, mbjellje fidanesh pyjore, peshkim, montim cmontim skelash catering etj. Nga keta 85 persona te deklaruar, mesatarja vjetore e deklarimit per persona te punesuar ne sektorin e gatimit eshte 11 persona me profilet e mëposhtme:

Kuzhinier.

Ndihmës në kuzhinë

Kuzhinier.

Inxhinier kimist

Kuzhinier.

Sanitar

Sanitar

Punëtor kuzhinë

Larës enësh me dorë

Ndihmës në kuzhinë

Këta janë stafi i cili ka të deklaruar NIKA në tatime sipas pozicioneve të punës sipas pozicioneve të punës.

Në DST është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017- dhjetor 2017”. Operatori ka mesatare vjetore punonjës të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit 11 punonjës ndërsa pjesa tjetër i ka profilet e:

inxhinier elektrik

inxhinier shpimi puse nalte dhe inxhinier zbatimi në ndërtim

Inxhinier hidrolog

Punëtor krahu në ndërtim godin

Jurist

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Punëtorë ngarkim-shkarkimi

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Punëtor krahu në ndërtim godin

Magaznier

Drejtor i përgjithshëm në ndër

Punëtor krahu

Asistent ligjor

Teknik ndërtim/inxhinieri civil

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Hidraulik

Inxhinier mekanik

Karpentier

Punëtor krahu

Shofer

Ekonomist

Mjekë të përgjithshëm
Teknik i mesëm ndërtimi
Shofer
Shofer
Punëtor krahu për shembje
inxhinier gjeolog
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu në ndërtim godin
Topograf
inxhinier mjedisi -trajtim ujë
Teknik ndërtim/inxhinieri civi
Arkëtar zyre
Punëtor për sistemim malli
Bojaxhi për ndërtesa
Punëtor krahu pastrimi zyresh
Bojaxhi për ndërtesa
Punëtor krahu ne pastrami zyresh
Bojaxhi për ndërtesa
Hidraulik
Elektracist
Punëtor krahu në ndërtim godin
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Elektracist
Teknik i mesëm ndërtimi
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Elektracist
Shofer
Punëtor krahu per mirembajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu
Punëtor krahu
Shofer
Magazinier
inxhinier zbatimi në ndërtim
Shofer
Punëtor per sistemim malli
Punëtor krahu në ndërtim rruge
Hidraulik
Elektracist
Punëtor krahu
Punëtor krahu

*Punëtor krahu për mirëmbajtje
Mbështjellës armature me dorë
inxhinier pyjesh*

Jurist

Shtrues pllakash

Shofer makine

Arkëtar zyre

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Referuar pozicioneve të mesiperme të kompanisë NIKA asnjë nga pozicionet e kerkuara nuk i përmbush kërkesat e DST si punonjës shtetërorë.

Sa më lart KVO ka arritur në konkluzion të gabuar duke e kualifikuar këtë operator ekonomik në këtë procedurë prokuruese.

Sa më lart O.E. NIKA duhet skualifikuar nga kjo procedurë prokuruese.

Referuar kapacitetit teknik në DST të kësaj procedurë prokuruese; 3.4 Kapaciteti teknik

- 1. Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, shërbime të ngjashme në vlerën totale jo më pak se 40 % e fondit limit.*

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e lidhur si dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve dhe / ose*
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

Duke ju referuar ekstraktit Historik të QKB-se se OE NIKA ky i fundit nuk ofron shërbim në asnjë spital për tju referuar kontratave të ngjashme. Duke qenë se kontrata të ngjashme janë vetëm ofrimi në spitale publike apo private pasi shërbimi i kërkuar është shumë specifik dhe si i ngjashëm mund të referohet vetëm ofrimin të shërbimit në spitale të ngjashme. Pra as ky kusht nuk është plotësuar nga subjekti i kualifikuar i pari. Duke ju referuar konstatimeve të mesiperme, KVO-ja ka arritur në konkluzion të gabuar në kualifikimin e operatorit Nika. Edhe nëse është bashkim Operatorësh me OE SILVER edhe ky operator ekonomik ka të deklaruar një mesatare vjetore 5 punonjësish shërbimi të gatimit. Edhe nëse do të ishte bashkim operatorësh mesatarja vjetore do të ishte 16 punonjës pra jo më shumë se 45% e personave të kërkuar në DST.

Sa më lart na lind dyshimi për paraqitje të deklaratime të rreme apo dokumenteve të fallcifikuara nga ky subjekt në këtë procedurë prokuruese.

ALAR FOOD & SERVICE do të ndjeke të gjithë procedurën administrative dhe atë penale, për të vënë para përgjegjësisë personat të cilët kanë kualifikuar O.E. NIKA në kundërshtim me kërkesat e DST të publikuara për këtë procedurë prokuruese, duke na kualifikuar të dytët në këtë procedurë prokuruese.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës kërkojmë që në përfundim të shqyrtimit të ankesës të skualifikojë O.E. NIKA ose bashkimin e OE NIKA & SILVER, dhe të na rendisë të parët si oferte të suksesshme, O.E. ALAR FOOD & SERVICE në renditjen përfundimtare të kësaj procedurë prokuruese.

II.3.2. Në datën 11.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 365/1 prot., 355/1, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën, ndërkohë që operatori ekonomik sqaron se nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e paraqitur. Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton:

[...]

Në përgjigje të ankesës Tuaj protokolluar me tonën me nr. 365 prot, datë 05.04.2018 dhe nr. 355 prot., datë 04.04.2018 [...] ku ju ankimoni kualifikimin e kompanisë së renditur në vendin e parë Nika shpk apo bashkimit të operatorëve ekonomikë "NIKA" Shpk dhe "Silver" Shpk ju sqarojmë se: Ne lidhje pretendimin se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Nika" Shpk dhe "Silver" Shpk dhe konkretisht operatori ekonomik "Nika" sh.p.k. nuk përmbush kërkesën për kualifikim: "Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.*
- *Listepagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.*

Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj në lidhje me këtë pikë nuk qëndron dhe bashkimi i operatorëve që ju përmendni në ankesën tuaj nuk ekziston në këtë procedurë. Në këtë procedurë bashkimi i operatorëve i renditur i pari është "Nika" shpk dhe "Dajti Park 2007" shpk.

Në lidhje me pretendimin se referuar ekstraktit historik të QKB-së se operatori ekonomik "NIKA" Shpk nuk ofron shërbime me asnjë spital referuar kontratave të ngjashme. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj në lidhje me këtë pikë nuk qëndron pasi kërkesa për kualifikim i referohet kontratave të ngjashme jo të njëjta. Gjithashtu sqarojmë edhe njëherë se në këtë procedurë bashkimi i operatoreve i renditur i pari është "NIKA" Shpk dhe "DAJTI PARK 2007" Shpk.

Për sa më sipër, ankesa Juaj nuk merret parasysh.

II.3.3. Në datën 13.04.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Alar Food & Service" sh.p.k. & "Serenissima Ristorazione" SPA ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor.

II.3.4. Në datën 25.04.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur shkresën e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 752/2 prot., me objekt "Shtesë në dosjen e ankimit nr. 752, datë 13.04.2018 "Shërbimi i gatimit të ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës", në të cilën argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor, Ministria e Brendshme me shkresën 365/1 Prot dt 11.04.2018 "Kthim Pergjigje", dhe shkresën 365/1 355/1 dhe shkresës 345/1 dt 11.04.2018, "Kthim Pergjigje" referuar pikës 2 konstatojmë se B.O. Nika dhe Dajti Park 2007, nuk kanë ofertuar sipas kërkesave në DST, si dhe referuar nr të punonjësve që ka B.O. ka parashikuar se vetëm për 4 vjet mund ta ofrojnë këtë sasi për këtë shërbim ku cmimi për muaj sipas llogarive është 2 263 264 leke pa tvsh në muaj për katë vite, duke e bërë 3 017 685.8 leke në muaj pa tvsh.

KVO-ja jo në kundërshtim me "Neni 51 Ndalimi i modifikimit të ofertave 1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën. 3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji”

Dhe në kundërshtim me Neni 53 Shqyrtimi i ofertave

1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit pa renë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:

a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar:

b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik. i bërë sipas pikës 2 të këtij neni;

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji:

ç) në rastet e parashikuara në nenin 26 të këtij ligji.

Ofertën e kanë ndryshuar dhe në vlerë dhe në afatë duke e bërë nga oferte të pavlefshme në oferte të vlefshme gje e cila i rëndon me faj dhe besojmë se mund të klasifikohet dhe si veper penale si veprim. Argumentimi i mëposhtëm është dhe me shembuj konkrete dhe me vendime analoge të KPP-se për situatë të ngjashme. Numri i punonjësve të sektorit të shërbimit të ushqimit të kompanisë Nika sh.p.k të paraqitura në listëpagesa nuk është sipas raportit të pjesëmarrjes në Bashkimin Ekonomik të Operatorëve.

1. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017 dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 dhjetor 2017.

Listepagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 dhjetor 2017.

Per procedurën objekt ankimi, Nika ka 87.3% të procedurës kështu që duhet të ketë 31 persona të punësuar në sektorin e ushqimit.

Referuar listepagesave 0.E. Nika ka te punesuar ne sektorin e sherbimit te gatimit 12 punonjes nga 31 qe duhet te kishte ne kete sektor. Per kete arsye bashkimi i Operatoreve Nika dhe Dajti duhet skualifikuar nga kjo procedure prokuruese.

Referuar ankimimit te Sori-al per kete procedure prokuruese ky ankimim nuk duhet te pranohet pasi eshte dorezuar jashte afatit 17 ditor.

[...]

Ka nje hedhje gabim ne dt e ankimimit nga ana e sekretarisë se KPP pasi ankesa eshte dorezuar me dt 18.04.2018 ora 13:55 ndersa ne regjistrin e ankimimeve te muajit prill eshte: 17.04.2018

Por edhe nga nga kjo hedhje gabim, e dates ne sistem, perseri ankesa e Sori-Al nuk mund te shqyrtohet pasi eshte dorezuar jashte afatit. Lidhur me kete konstatim i jemi referuar dhe vendimeve per situata te ngjashme te mara nga KPP si psh, Vendim K.P.P. 311/2017 dt.16.05.2017. njoftimi I kualifikimit eshte bere me dt 29.03.2018, pra nga dt 30.03.2018 dhe deri me dt 18.4.2018 jane 19 dite, pra ankesa eshte dorëzuar jashte afatit ligjor dhe si e tille nuk duhet pranuar. Persa i perket konstatimit te pare per subjektin NIKA, i jemi referuar vendimeve analoge te KPP se. nese ju duhen mund t'jua a veme kopje ne dicpozicion.

II.4. Në datën 29.03.2018 operatori ekonomik “Sori - Al” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 05.04.2018, operatori ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë të renditur në vendin e parë dhe të dytë. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

Shoqëria “SORI-AL“ Sh.p.k pretendon se kualifikimi i operatorëve ekonomik “NIKA“ dhe “Alar Food & Service” është bërë ne shkelje te Ligjit “Per Prokurimin Pub/ik”, te ndryshuar dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 914. date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, duke qënë se këto shoqëri kanë mangësi dhe parregullsi dokumentacioni të domosdoshëm për kualifikim si me poshte vijon:

(1) ALAR FOOD & SERVICE SH.P.K

Bazuar në informacionin që disponojmë, na rezulton se ky operator ekonomik ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik për këtë procedura prokurimi dhe referuar kriterëve te kërkuara nga autoriteti juaj kontraktor shoqëria jonë pretendon se:

1. Kontrata e Bashkëpunimit dhe Prokura e Posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku parashikohet se: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dorëzohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi....” pasi në kontratën e paraqitur në kundërshtim me sa më sipër, përveç mangësive të tjera, nuk është bërë ndarja e shërbimit përkatës per sejcilin prej operatoreve ekonomike, por eshte bere vetem ndarja e fitimit.

- Po keshu ne kontraten e bashkepunimit nuk eshte parashikuar neni 423 "Detyrimet Solidare" i Kodit Civil, duke mos parashikuar keshu elementin më të rëndesishëm mbrojtës te Autoritetit Kontraktor, i cili eshte pergjegjesia ne rast mos ekzekutimit me sukses të kontratës.*
- 2. Prokura e Posaçme ku janë përcaktuar tagrat që i jepen përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomik, nuk i referohet objektit të procedurës së prokurimit REF 48682-0216-2018, të publikuar më datë 19.02.2018, me datë hapje oferte 15.03.2018. Rrjedhimisht kjo prokurë e posaçme është e pavlefshme.*
 - 3. Anëtarët e bashkimit nuk plotësojnë numrin e të punësuarve të gatimit për periudhën e kërkuar. Listëpagesat e dorëzuara nuk janë të vulosura nga administrata tatimore.*
 - 4. Bazuar në të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, poseduesi i kuotave të shoqërisë "Alar Food & Service" sh.p.k. ka lidhur Kontratë Pengu nr. 2650 rep, nr. 1184 kol datë 23.06.2015 mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri me Raiffeisen Bank në përmbushje të detyrimeve të Kontratës së Kredisë Bankare nr. 2648 rep., nr. 1182 kol, datë 23.06.2015. Vendosja e kuotave te kapitalit të shoqërisë si garanci për zbatimin e kontratës së kredisë bankare, cënon sigurinë e subjektit (operatorit ekonomik) për të ofruar qëndrueshmëri dhe vijimësi në përmbushjen e objektit të kontratës me Autoritetin Kontraktor, në rastin e shpalljes fitues.*
 - 5. Ofertuesi nuk plotëson kriterin për paraqitjen e bilancit të vitit 2014, bazuar ky pretendim në ekstraktin e regjistrimit tregtar të shoqërisë "Alar Food & Service" Sh.p.k. ku vërtetohet se ky operator është regjistruar më datën 08.06.2015 (bashkelidhur kopje e ekstraktit te shoqërisë). Mosplotësimi i këtij kriteri vjen ne kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", neni: 74 "Bashkimi i Operatorëve Ekonomik", Pikës 3, ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje,*
 - 6. Gjithashtu, pretendojme se asnjë anëtar i bashkimit të shoqërive nuk plotëson kriteret financiare apo teknike në raport me përqindjen e "fitimit" apo "ndarjes se shërbimeve përkatëse", duke mos plotësuar kërkesat e pikës 3 te nenit 74 te VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.*
 - 7. Dokumentet e dorëzuara nga njëri prej operatorëve të bashkimit, i cili është operator i huaj, nuk janë të legalizuara apo me vulë apostile. Ky fakt është evident ne te gjitha dokumentat qe ka paraqitur ne kete tender. Sikurse Ju e dini legalizimi i dokumentave të institucioneve të huaja eshte kusht i domosdoshem i parashikuar ne Konventen e Hages date 05.10.1961, per menyren e paraqitjes se dokumentave zyrtare ne nje shtet te huaj, Konvente ne te cilen aderon dhe Republika e Shqiperise. Gjithashtu ky fakt eshte pasqyruar dhe ne Legjislacionin e brendshem Kombetar dhe konkretisht ne VKM Nr. 134, date 07.03.2003 "Per vertetimin dhe legalizimin e dokumenteve te leshuara ne R.SH, per perdorim jashte vendit dhe te dokumenteve te huaja brenda vendit ", e ndryshuar.*
 - 8. Bazuar në dyshime të arsyeshme ngremë pretendimin tonë se oferta e paraqitur ka gabime në përmbajtje, si dhe gabime aritmetike që janë më shumë se 2 % e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

9. *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit për përvojë të sukseshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë prej 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, në raport me përqindjen e “fitimit” apo “ndarjes së shërbimeve përkatëse” duke mos plotësuar kërkesat e pikës 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014.*
10. *Anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik nuk plotësojnë kriterin për dorëzimin e certifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 22000:2005; ISO 18001:2007; (HACCP); ISO 14001:2004/ ISO 14001:2015; të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

Mungesa e këtyre elementeve thelbësorë në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Alar Food & Service” si bashkim operatorësh, duhej t’i mjaftonte Komisionit të Vlerësimit të ofertave për skualifikimin e këtij bashkimi.

(2) NIKA SH.P.K

Bazuar në informacionin që disponojmë, na rezulton se edhe ky operator ekonomik ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik për këtë procedurë prokurimi dhe referuar kritereve të kërkuara nga autoriteti juaj kontraktor shoqëria jonë pretendon se:

Asnje nga anëtarët e bashkimit të shoqërive nuk plotëson kriteret e mëposhtme:

1. *Nuk plotëson kriterin teknik të numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar. Listpagesat e dorëzuara nuk janë të vullosura nga administrata tatimore. Dokumentacioni i dorëzuar mbi punonjësit e kërkuar në tabelën e pikës 10 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.*
2. *Nuk plotësojnë kriterin teknik për disponimin e ambientit ku ushtrohet veprimtaria e shërbimit të gatimit të ushqimit të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në Shtojcën 8 të DST -së, Pikën 7 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.*
3. *Nuk plotëson kriterin financiar për “Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, 2015, 2016, 2017 ku vlera mesatare e xhiros gjatë 3 viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit”, në raport me përqindjen e “fitimit” apo “ndarjes së shërbimeve përkatëse”, duke mos plotësuar kërkesat e pikës 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.*
4. *Nuk plotëson kriterin financiar për “Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit 2014, 2015, 2016 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore ” në raport me përqindjen e “fitimit” apo “ndarjes së shërbimeve përkatëse”.*
5. *Nuk plotëson kriterin e veçantë për: “Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.*

6. Nuk plotëson kriterin teknik për realizimin e shërbimeve të ngjashme në vlerën totale jo më pak se 40% të fondit limit, në raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse duke mos plotësuar kërkesat e pikës 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
7. Nuk plotëson kriterin për dorëzimin e certifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 22000:2005; ISO 18001:2007; (HACCP); ISO 14001:2004/ ISO 14001:2015; të cilat duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
8. Kontrata e Bashkëpunimit dhe Prokura e Posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.
Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. ”, pasi në kontratën e paraqitur në kundërshtim me sa më sipër, përveç mangësive të tjera, nuk është bërë ndarja e shërbimit përkates për sejcilin prej operatoreve ekonomikë, por është bërë vetëm ndarja e fitimit. Po kështu në kontratën e bashkëpunimit nuk është parashikuar neni 423 “Detyrimet Solidare” i Kodit Civil, duke mos parashikuar kështu elementin me të rendesishëm mbrojtës të autoritetit kontraktor i cili është përgjegjësia në rast mos ekzekutimit me sukses të kontratës.
9. Prokura e Posaçme ku janë përcaktuar tagrat që i jepen përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomik, nuk i referohet objektit të procedurës së prokurimit REF-4868202-16-2018, të publikuar më datë 19.02.2018, me datë hapje oferte 15.03.2018. Rrjedhimisht kjo prokurë e posaçme është e pavlefshme.
10. Bazuar në dyshime të arsyeshme ngremë pretendimin tonë se oferta e paraqitur ka gabime në përmbajtje, si dhe gabime aritmetike që janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Oferta është përpiluar mbi të dhënat e procedurës së prokurimit të datës 05.02.2018, me fond limit 188,208,710 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e dyqind e tetë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSh, me afat 4-vjeçar, procedurë kjo e anuluar nga autoriteti kontraktor. Ndërkohë që procedura për të cilën operatori ka dorëzuar ofertën e vet është parashikuar me afat 3-vjeçar dhe me fond limit 134,814,264 (njëqind e tridhjetë e katër milion e tetëqind e katërmëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
11. Ofertuesi ka marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të një procedure të anuluar, konkretisht të procedurës me datë zhvillimi 05.02.2018, ku sasia e dietave dhe afati kohor për ofrimin e shërbimit janë parashikuar për 4 (katër vite). Rrjedhimisht Operatori nuk plotëson kriterin për dorëzimin e deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas kërkesave të DST-së.

KVO-ja në vlerësimin e kësaj oferte duhet të zbatonte nenin 74, pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: “Secili prej anetareve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ata teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizimi të përcaktuara në aktmarrëveshje, "dhe të skualifikonte operatorin "NIKA".

Sa më sipër, për të siguruar zbatim të drejtë të ligjit dhe trajtim të barabartë e jo diskriminues të Operatorëve ekonomike kërkojmë nga ana juaj:

Skualifikimin nga kjo procedurë prokurimi të shoqërive:

- 1. "NIKA" Sh.p.k;*
- 2. "Alar Food & Service" Sh.p.k;*

II.4.2. Në datën 11.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 360/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën me argumentin si më poshtë vijon:[...]

Në përgjigje të ankesës Tuaj protokolluar me Tonën me nr. 360 prot, datë 05.04.2018, në lidhje me procedurën: Procedure e Hapur, me objekt "Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Spitalin Universitar të Traumës" me fond limit 134,814,264 (njëqind e tridhjetë e katër milion e tetëqind e katërmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ku ju pretendoni se kualifikimi i shoqërive "NIKA" dhe "Alar Food & Service" është bërë në shkelje të ligjit "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ju sqarojmë se:

Në lidhje me bashkimin e operatorëve ekonomikë "ALAR FOOD & SERVICE" shpk dhe "SERENISSIMA RISTORACIONE" SPA ju pretendoni se:

Ofertuesi "Alar Food & Service" shpk nuk plotëson kriterin për paraqitjen e bilancit të vitit 2014. Pas verifikimeve të bëra u konstatua se operatori ekonomik "Alar Food & Service" shpk nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2014 duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga të dy operatorët ekonomikë, vlerës së ofertës ekonomik të dorëzuar për këtë procedurë prokurimi si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit Neni 53 (Shqyrtimi i ofertave) ku përcaktohet se: "4. Autoriteti kontraktor vlerëson një afërtë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj" grupi i shqyrtimit vendosi që ta konsiderojë si devijim të vogël.

Poseduesi i kuotave të shoqërisë "Alar Food&Service" shpk ka lidhur kontratë pengu nr. 2650 rep., nr. 1184 kol, datë 23.06.2015 mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri me Raiffeisen Bank gjë e cila cënon sigurinë e subjektit për të ofruar qëndrueshmëri dhe vijimësi në përmbushjes së objektit të kontratës me autoritetin kontraktor në rastin e shpalljes fitues. Sqarojmë se kontrata e pengut nuk përbën kusht skualifikimi, pasi nuk plotëson asnjë nga kushtet e nenit 45 "Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve" të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM së 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nuk është bërë ndarja e shërbimit përkatës për secilin prej operatorëve ekonomikë, por është bërë vetëm ndarja e

fitimit. Pas verifikimit të bërë duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga të dy operatorët ekonomikë, vlerës së ofertës ekonomik të dorëzuar për këtë procedurë prokurimi si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit Neni 53 (Shqyrtimi i ofertave) ku përcaktohet se: “4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera. të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj” grupi i shqyrtimit vendosi që ta konsiderojë si devijim të vogël mangësitë e lartpërmendura në kontratë dhe prokurë.

Një anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk plotëson kriteret financiare apo teknike në raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Dokumentet e dorëzuar nga njeri nga operatorët ekonomikë të bashkimit i cili është i huaj, nuk janë të legalizuara apo me vule apostile. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Bazuar në dyshime të arsyeshme ku ju ngrini pretendimin se oferta e paraqitur ka gabime në përmbajtje, si dhe gabime aritmetike që janë më shumë se 2 % e vlerës së ofertës ekonomike. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerën prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, në raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomike nuk plotësojnë kriterin për dorëzimin e certifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 22000:2005; ISO 18001 :2007; (HACCP); ISO 14001 :2004/ISO 14001:22015 ku këto të jenë të lëshuara nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akredituar ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Anëtarët e bashkimit nuk plotësojnë numrin e te punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar. Listë pagesat e dorëzuara nuk janë të vulosura nga administrata tatimore. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Në lidhje me bashkimin e operatorëve ekonomikë “NIKA” Shpk dhe “DAJTI PARK 2007” Shpk ju pretendoni se: .

Nuk plotëson kriterin financiar për “Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, 2015, 2016, 2017 ku vlera mesatare e xhiros gjatë 3 viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit” në raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin financiar për “Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit 2014, 2015, 2016 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore ” ne raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin e veçantë për: "Vërtetim që konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatorit që është i regjistruar në Shqipëri", pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin teknik për realizimin e shërbimeve të ngjashme në vlerën totale jo më pak se 40% e fondit limit në raport me përqindjen e fitimit apo ndarjes së shërbimeve përkatëse. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin për dorezimin e certifikatave ISO 9001-2008/ASO 9001-2015; ISO 22000:2005; ISO 18001:2007; (HACCP), ISO 14001:2004/ISO 14001:2015 të cilat duhet të jenë të lëshuara nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akredituar ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohtun nga Republika e Shqipërisë. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin teknik të numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar. Listë pagesat e dorëzuar nuk janë të vullosura nga administrata tatimore. Dokumentacioni i dorëzuar mbi punonjësit e kërkuar në tabelën e pikës 10 të kriterëve të veçanta të kualifikimit; nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Nuk plotëson kriterin teknik për disponimin e ambientit ku ushtrohet veprimtaria e shërbimit të gatimit të ushqimit të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në shtojcën 8 të DST-ve. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Prokura e posaçme nuk i referohet objektit të procedurës së prokurimit REF 48682-02-16-2018, të publikuar me datë 19.02.2018 me datë hapje oferte 15.03.2018. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Grupi i shqyrtimit të ankesës duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, vlerës së ofertës ekonomike të dorëzuar për këtë procedurë prokurimi e cila është edhe vlera më ulët në raport me ofertat e tjera të dorëzuara në këtë procedurë prokurimi, si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit Neni 53 (Shqyrtimi i ofertave) ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të "vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj" vendosi që të konsiderojë si devijim të vogël këtë lapsus.

Sa më sipër pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Bazuar në dyshime të arsyeshme ku ju ngrini pretendimin se oferta e paraqitur ka gabime në përmbajtje, si dhe gabime aritmetike që janë më shumë se 2 % e vlerës së ofertës ekonomike. Pas verifikimeve të bëra pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Ofertuesi ka marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të një procedure të anuluar, konkretisht të procedurës me datë zhvillimi 05.02.2018 ku sasia e dietave dhe afati kohor për ofrimin e shërbimit janë parashikuar për 4 vite dhe rrjedhimisht operatori nuk plotëson kriterin për dorëzimin e deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas kërkesave të DST-ve. Grupi i shqyrtimit të ankesës duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, vlerës së ofertës ekonomike të dorëzuar për këtë procedurë prokurimi e cila është edhe vlera më ulët në raport me ofertat e tjera të dorëzuara në këtë procedurë prokurimi si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 53 (Shqyrtimi i ofertave) ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj" vendosi që të konsiderojë si devijim të vogël këtë lapsus.

Sa më sipër pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron.

Për sa më sipër, ankesa Juaj nuk merret parasysh.

II.4.3. Në datën 18.04.2018 operatori ekonomik "Sori - Al" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në autoritetin kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimes sqaron se: *Autoriteti Kontraktor në kthim përgjigjen nr. 360/1 prot., datë 11.04.2018. edhe pse e pranon se ka mangësi dhe gabime në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë Nika dhe Alar Food & Service në çdo rast merr përsipër t'i gjykojë ato ose si devijime të vogla ose si "lapsuse"*

Konkretisht, në shkresën nr. 360/1 prot., datë 11.04.2018. Autoriteti Kontraktor pranon se:

- 1. Ofertuesi "Alar Food & Service" (nën cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomik), nuk plotëson kriterin për paraqitjen e bilancit të vitit 2014, por grupi i shqyrtimit vendosi ta konsiderojë si devijim të vogël mungesën e bilancit.*
- 2. Kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", por grupi i shqyrtimit vendosi t'i konsiderojë si devijime të vogla mangësitë e lartpërmendura në kontratë dhe prokurë.*
- 3. Prokura e posaçme për bashkimin e operatorëve "NIKA" dhe "DAJTI PARK 2007" nuk i referohet objektit të procedurës së prokurimit REF: 48682-02-16-2018,...por grupi i shqyrtimit vendosi ta konsiderojë si devijim të vogël këtë lapsus.*
- 4. Oferta e paraqitur ka gabime në përmbajtje, si dhe gabime aritmetike që janë më shumë se 2 % e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Oferta është përpiluar mbi të dhënat e procedurës së prokurimit të datës 05.02.2018, me fond limit 188,208,710 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e dyqind e tetë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSh, me afat 4-vjeçar, procedurë kjo e anuluar nga autoriteti juaj kontraktor, por grupi i shqyrtimit vendosi ta konsiderojë si devijim të vogël këtë lapsus.*
- 5. Ofertuesi ka marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të një procedure të anuluar, konkretisht të procedurës me datë zhvillimi 05.02.2018, ku sasia e dietave dhe afati kohor për ofrimin e shërbimit janë parashikuar për 4 (katër vite) por grupi i shqyrtimit vendosi ta konsiderojë si devijim të vogël këtë lapsus.*

Dashmirësia e Grupit të shqyrtimit për të klasifikuar mangësitë dhe gabimet në “devijime të vogla” ose “lapsuse” ka tejkaluar kompetencat që ligji i ka lejuar KVO-së së një Autoriteti Kontraktor, pasi në Nenin 53 të Ligjit “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është për përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 424/1 prot., datë 24.04.2018, protokolluar me tonën në datën 30.04.2018, me objekt “*Informacion*”, shkresës me nr. 404/1 prot., datë 20.04.2018, protokolluar me tonën në datën 23.04.2018, me objekt “*Informacion*”, shkresës nr. 429/1 prot., datë 27.04.2018, protokolluar me tonën në datën 30.04.2018, me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,



III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA, se operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nga 85 persona te deklaruar, mesatarja vjetore e deklarimit per persona te punesuar ne sektorin e gatimit eshte 11 persona me profilet e mëposhtme: Kuzhinier, Ndihmës në kuzhinë, Kuzhinier, Inxhinier kimist, Kuzhinier, Sanitar, Sanitar, Punëtor kuzhinë, Larës enësh me dorë, Ndihmës në kuzhinë, stafi i cili ka të deklaruar NIKA në tatime sipas pozicioneve të punës. Referuar pozicioneve te mesiperme te kompanise NIKA asnje nga pozicionet e kerkuara nuk i permbush kerkesat e DST si punonjes sherbimi gatimi. Në DST është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017- dhjetor 2017”. Referuar pozicioneve te mesiperme te kompanise NIKA asnje nga pozicionet e kerkuara nuk i permbush kerkesat e DST si punonjes sherbimi gatimi;

si edhe pretendimit të operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. se asnje nga anetaret e bashkimit te shoqerive nuk plotëson kriterin teknik të numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar. Listpagesat e dorëzuara nuk janë të vulosura nga administrata tatimore. Dokumentacioni i dorëzuar mbi punonjësit e kërkuar në tabelën e pikës 10 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 3.3. Kapaciteti Teknik, pikat 9, 10 e 11, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar kriteret: “Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguar për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.
- Listepagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes me profesione si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	3
2	Mercollog/Kimist/teknolog	2
3	Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi	15
	Total	20

- Punonjësit në tabelën e mësipërme duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune dhe të paraqesin dokumentacionin sipas profesioneve si më poshtë:

- a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libereze pune.
- b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libereze pune.
- c) Për ndihmës kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vendin e parë, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k., nga ku shoqëria “Nika” sh.p.k. do të kryejë punimet në masën prej 87.3 % dhe shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. do të kryejë punimet në masën prej 12.7 %. Konkretisht shoqëria “Nika” sh.p.k. do të kryejë këto punime:

Dieta nr. 1 Normale, Dieta nr. 2 Hidrike A, Dieta nr. 2 Hidrike B-1, Dieta nr.2 Hidrike B-2, Dieta nr. 3 Sëmundje Infektive, Dieta nr. 4 e lëngët, Dieta nr. 5 e qullët, Dieta nr. 6 për hepatitët, Dieta nr. 7 Blanda, Dieta nr.8 për Ulcerozën, Dieta nr. 9 Entero – Kolitin, Dieta nr. 11 Hiperprot e varfër me Na, Dieta nr. 12 Diabetike e ekuilibruar, Dieta nr. 13 Norma Kolike e varfër me Na, Dieta nr.14 Hiperprot. Hipergl e pasur me Ca e Fe.

Shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. do të kryejë këto punime:

Norma 4300 k/kal për mjek.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Nika” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

“Nika” sh.p.k.

- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe znj. E.S.K. në profesionin Kimiste – Teknologe Ushqimore, e lidhur në datën 05.01.2016, pa afat të caktuar; Diplomë e nivelit të dytë në Kimi Ushqimore, CV, Librezë Pune;

- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. A.H. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 26.01.2017, pa afat të caktuar; Çertifikatë për kursin 9 mujor për kuzhinier, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. R.P. në profesionin Shërbyes Gatimi, e lidhur në datën 02.12.2016, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. F.K. në profesionin Ndhmës Kuzhinier, e lidhur në datën 05.09.2015, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. N.SH. në profesionin Shërbyes Gatimi, e lidhur në datën 05.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. L.A. në profesionin Shërbyes Gatimi, e lidhur në datën 26.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe znj. F.SH. në profesionin Shërbyes Gatimi, e lidhur në datën 12.12.2016, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z. M.Z. në profesionin Ndhmës Kuzhinier, e lidhur në datën 18.01.2015, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.H.M. në profesionin Ndhmës Kuzhinier, e lidhur në datën 01.08.2016, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.GJ.P. në profesionin Ndhmës Kuzhinier, e lidhur në datën 05.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.P.K. në profesionin Ndhmës Kuzhinier, e lidhur në datën 31.05.2015, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.A.G në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 13.06.2013, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.A.Q. në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 01.01.2012, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.Gj.P. në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 07.07.2014, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.N.K. në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 01.01.2012, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe znj.GJ.Q. në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 01.01.2012, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe znj.A.A. në profesionin Shpërndarës Ushqimi, e lidhur në datën 25.01.2013, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe z.A.A. në profesionin Kimist – Teknolog Ushqimore, e lidhur në datën 01.06.2016, pa afat të caktuar; Diplomë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Çertifikatë notash, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe znj.M.R. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 01.10.2016, pa afat të caktuar; Çertifikatë për kursin e Kuzhinës, Librezë Pune;
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a;
- Listëpagesat për periudhën Janar – Dhjetor 2017, ku pasqyrohet numri i punonjësve me të dhënat përkatëse (emër, mbiemër), profesioni (kodi përkatës) etj.

“Dajti Park 2007” sh.p.k.

- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.XH.Q. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Çertifikatë për kursin e Kuzhinës, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.SH.Q. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Çertifikatë për kursin e Kuzhinës, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.E.K. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Çertifikatë për kursin e Kuzhinës, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.SH.Q. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Çertifikatë për kursin e Kuzhinës, Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.R.Z. në profesionin Ndhimës Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.S.B. në profesionin Ndhimës Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.E.B. në profesionin Ndhimës Kuzhinier, e lidhur në datën 02.10.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe znj.M.M. në profesionin Pjata larëse, e lidhur në datën 03.05.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.I.Q. në profesionin Shofer, e lidhur në datën 03.05.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.D.K. në profesionin Shofer, e lidhur në datën 03.05.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.G.B. në profesionin Shofer, e lidhur në datën 03.05.2017, pa afat; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.B.M. në profesionin Mercellog Ushqimor, e lidhur në datën 02.02.2018, me afat 3 vjeçar, Diplomë e Nivelit të Dytë në Inxhinieri Agroushqimore profili Teknologji Agroushqimore, Diplomë e Nivelit të Parë në Inxhinieri Agroushqimore profili Teknologji Agroushqimore, Librezë pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe z.F.S. në profesionin Teknologut Ushqimor, e lidhur në datën 02.02.2018, me afat 3 vjeçar, Dëftesë Pjekurie në specialitetin Teknologji Ushqimore, lëndët mësimore, Çertifikatë e përgatitjes profesionale, Librezë pune.
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a;
- Listëpagesat për periudhën Janar – Dhjetor 2017, ku pasqyrohet numri i punonjësve me të dhënat përkatëse (emër, mbiemër), profesioni, etj.

III.1.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA pretendon se:

Bazuar ne ligjin e prokurimit publik neni 63 si dhe Kodit te Procedurave Administrative ankimojme kualifikim e kompanise se kualifikuar ne vend te pare “Nika” apo bashkimit te O.E. NIKA & SILVER per arsyet e meposhtme:

Ne DST eshte kerkuar:

3.3 Kapaciteti teknik:

10. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017 – dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 – dhjetor 2017.*
- Listëpagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 dhjetor 2017.*

Duke u nisur nga kjo kerkese ne DST te procedures objekt ankese na rezulton se kompania NIKA ne tatime ka te deklaruar nje mesatare prej 85 personash per te ushtruar veprimtarine e kompanise sipas objektit i cili pershin veprimtari ne ndertim, ne pyllezime dhe mbreshtim pyjesh, punime mermeri, transport nderkombetar, mbjellje fidanesh pyjore, peshkim, montim cmontim skelash catering etj. Nga keta 85 persona te deklaruar, mesatarja vjetore e deklarimit per persona te punesuar ne sektorin e gatimit eshte 11 persona me profilet e mëposhtme:

Kuzhinier.

Ndihmës në kuzhinë

Kuzhinier.

Inxhinier kimist

Kuzhinier.

Sanitar

Sanitar

Punëtor kuzhinë

Larës enësh me dorë

Ndihmës në kuzhinë

Këta janë stafi i cili ka të deklaruar NIKA në tatime sipas pozicioneve të punës sipas pozicioneve të punës.

Në DST është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017- dhjetor 2017”. Operatori ka mesatare vjetore punonjës të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit 11 punonjës ndërsa pjesa tjetër i ka profilet e:

inxhinier elektrik

inxhinier shpimi puse nalte dhe inxhinier zbatimi në ndërtim

Inxhinier hidrolog

Punëtor krahu në ndërtim godin

Jurist

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Punëtorë ngarkim-shkarkimi

Punëtor krahu për mirëmbajtje

Punëtor krahu në ndërtim godin

Magaznier

Drejtor i përgjithshëm në ndër

Punëtor krahu

Asistent ligjor
Teknik ndërtim/inxhinieri civil
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Hidraulik
Inxhinier mekanik
Karpentier
Punëtor krahu
Shofer
Ekonomist
Mjekë të përgjithshëm
Teknik i mesëm ndërtimi
Shofer
Shofer
Punëtor krahu për shembje
inxhinier gjeolog
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu në ndërtim godin
Topograf
inxhinier mjedisi -trajtim ujë
Teknik ndërtim/inxhinieri civil
Arkëtar zyre
Punëtor për sistemim malli
Bojaxhi për ndërtesa
Punëtor krahu pastrimi zyresh
Bojaxhi për ndërtesa
Punëtor krahu ne pastrami zyresh
Bojaxhi për ndërtesa
Hidraulik
Elektracist
Punëtor krahu në ndërtim godin
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Elektracist
Teknik i mesëm ndërtimi
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Elektracist
Shofer
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Punëtor krahu
Punëtor krahu
Shofer

Magaziniër
inxhinier zbatimi në ndërtim
Shofer
Punëtor për sistemim malli
Punëtor krahu në ndërtim rruge
Hidraulik
Elektricitist
Punëtor krahu
Punëtor krahu
Punëtor krahu për mirëmbajtje
Mbështjellës armature me dorë
inxhinier pyjesh
Jurist
Shtrues pllakash
Shofer makine
Arkëtar zyre
Punëtor krahu për mirëmbajtje

Referuar pozicioneve të mesipërme të kompanisë NIKA asnjë nga pozicionet e kërkuara nuk i përmbush kërkesat e DST si punonjës shërbimi gatimi.

Sa me lart K VO ka arritur në konkluzion të gabuar duke e kualifikuar këtë operator ekonomik në këtë procedurë prokuruese.

Sa me lart O.E. NIKA duhet skualifikuar nga kjo procedurë prokuruese,

III.1.5. Ndërsa operatori ekonomik “Sori – AI” sh.p.k. në lidhje me operatorin ekonomik “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., në ankesën e paraqitur pretendon se:

Bazuar në informacionin që disponojmë, na rezultoi se edhe ky operator ekonomik ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik për këtë procedurë prokurimi dhe referuar kritereve të kërkuara nga autoriteti juaj kontraktor shoqëria jonë pretendon se:

Asnjë nga anëtarët e bashkimit të shoqërive nuk plotëson kriteret e mëposhtme:

Nuk plotëson kriterin teknik të numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar. Listëpagesat e dorëzuara nuk janë të vullosura nga administrata tatimore. Dokumentacioni i dorëzuar mbi punonjësit e kërkuar në tabelën e pikës 10 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

III.1.6. Autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimesve, sqaron se, pas verifikimeve të kryera, pretendimi në lidhje me këtë kriter nuk qëndron.

III.1.7. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mesipërme rezultoi se, ka mangësi në plotësimin e kriterit për numrin e punonjësve, dhe konkretisht kriterit për punonjësit në fushën e gatimit, pasi operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në përputhje me pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër nuk ka paraqitur dhe nuk plotëson numrin e punonjësve të gatimit (kuzhinier, mercellog/kimist/teknolog, ndihmës kuzhine/shërbyes gatimi), sipas përqindjes së tij të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, duke shqyrtuar edhe listëpagesat e paraqitura dhe specifikisht, referuar pretendimeve të ankimesve, në kolonën e listëpagesave është përcaktuar emërtimi “Kodet detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi”. Në VKM nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, janë të përcaktuara me kodet përkatëse profesionet sipas listës kombëtare.

Nisur nga pretendimet e ankimesve, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrtoi dokumentacionin e punonjësve të deklaruar nga kjo shoqëri, si punonjës me profesione në fushën e gatimit, nga ku rezultoi se ka një mospërputhje mes profesioneve të përcaktuara në kontratë me ato të deklaruar në listëpagesa. Sqarojmë se, referuar, si emërtimeve të profesioneve në kontratat e punës të deklaruar nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k., ashtu edhe listëpagesave, ku verifikohet kodi i profesionit, i ballafaquar ky kod me përcaktimin e bërë në VKM nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, numri i punonjësve në fushën e gatimit të paraqitur nga kjo shoqëri për të realizuar këtë kontratë, në përputhje dhe përpjesëtim me përqindjen e marrë përsipër, nuk arrin të jetë sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Bazuar në kodet e profesioneve të deklaruar në listëpagesat, të cilat janë të konfirmuara edhe nga ana e organeve përkatëse, konstatohet se operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk plotëson numrin e kërkuar në dokumentat e tenderit për punonjësit në fushën e gatimit, pra pavarësisht se ai ka paraqitur një numër të caktuar punonjësish, që në pamje të parë duket i plotësuar, vetëm për nga ana numerike, pa verifikuar dokumentacionin shoqëruar apo profesionin, por që në shqyrtim në brendësi në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, ka mangësi, pasi nuk ka paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, dokumentacionin specifik: kontrata pune, librezë pune dhe diploma ose çertifikata kualifikimi sipas profesioneve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si edhe nuk plotëson numrin e tyre për profesionet kuzhinier (me gjithë dokumentacionin e duhur – kontratë pune, diplomë ose çertifikatë kualifikimi, librezë pune), mercellog/kimist/teknolog, apo ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi.

Konkretisht, referuar profesioneve të tyre, të deklaruar edhe pranë organeve tatimore, rezultoi se operatori “Nika” sh.p.k. për punët e marra përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit (87.3% pjesa e punës e marrë përsipër prej tij), nuk plotëson numrin për punonjësit në fushën e gatimit kuzhinier, mercellog/kimist/teknolog dhe ndihmës kuzhine/shërbyes gatimi, me gjithë dokumentacionin e duhur dhe të kërkuar, si edhe për të gjithë periudhën Janar – Dhjetor 2017.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, duke marrë në konsideratë vetëm dokumentacionin për punonjësit, për të cilët është i plotë, sipas të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor, pra është i shoqëruar me kontratë pune, librezë pune ose diplomë / çertifikatë kualifikimi, në varësi të profesionit të kërkuar, si edhe referuar kodit të profesionit të listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të deklaruar në organet tatimore, sipas leximit dhe detajimit të këtyre kodeve në VKM nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. dukshëm nuk plotëson numrin e punonjësve në fushën e gatimit.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për numrin e punonjësve, nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.9. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për numrin e punonjësve në fushën e gatimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër, aq më tepër kur ky operator është edhe përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve dhe ka një përqindje të konsiderueshme të punëve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.11. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. se asnjë nga anetaret e bashkimit të shoqërive “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k. nuk plotësojnë kriterin teknik për disponimin e ambientit ku ushtrohet veprimtaria e shërbimit të gatimit të ushqimit të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në Shtojcën 8 të DST -së, Pikën 7 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 3.3. Kapaciteti Teknik, pika 7, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Per të plotësuar këto pike operatori ekonomike duhet të paraqesë:*

- *Dokumentacionin që vërteton pronesinë ose marrjen me qera të këtij ambienti.*
- *Leje e mjedisit e tipit C, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për objektin në fjalë.*
- *Leje higjieno - sanitare për objektin në fjalë.*
- *Aktin Teknik persa i perket masave mbrojtëse të zjarrit.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vendin e parë, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k., nga ku shoqëria “Nika” sh.p.k. do të kryejë punimet në masën prej 87.3 % dhe shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. do të kryejë punimet në masën prej 12.7 %. Konkretisht shoqëria “Nika” sh.p.k. do të kryejë këto punime:

Dieta nr. 1 Normale, Dieta nr. 2 Hidrike A, Dieta nr. 2 Hidrike B-1, Dieta nr.2 Hidrike B-2, Dieta nr. 3 Sëmundje Infektive, Dieta nr. 4 e lëngët, Dieta nr. 5 e qullët, Dieta nr. 6 për hepatitët, Dieta nr. 7 Blanda, Dieta nr.8 për Ulcerozën, Dieta nr. 9 Entero – Kolitin, Dieta nr. 11 Hiperprot e varfër me Na, Dieta nr. 12 Diabetike e ekuilibruar, Dieta nr. 13 Norma Kolike e varfër me Na, Dieta nr.14 Hiperprot. Hipergl e pasur me Ca e Fe.

Shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. do të kryejë këto punime:

Norma 4300 k/kal për mjek.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Nika” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

“Nika” sh.p.k.:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie në emër të shoqërisë “Nika” sh.p.k., për sipërfaqe truall dhe ndërtesë;
- Akt-Miratimi Higjeno Sanitar datë 19.02.2014, lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror, për vënien në shfrytëzim të objektit Magazinë ushqimore;
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Shkodër (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit), që është subjekt që kontrollohet nga AKU Shkodër dhe plotëson kushtet për ushtrimin e aktivitetit;

“Dajti Park 2007” sh.p.k.:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie në emër të shoqërisë “Vllaznia” sh.p.k., për sipërfaqe truall dhe ndërtesë;
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar datë 06.02.2017, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, për vënien në shfrytëzim të objektit Bar Restorant Hotel Pishinë;
- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në datën 03.07.2017, nga Drejtoria e M.Z.Sh-së;
- Leje e mjedisit e tipit C për ndikimin në mjedis;
- Akt miratimi leje mjedisi Tipi C;

III.2.4. Operatori ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. pretendon se asnjëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k. nuk plotëson kriterin për disponimin e ambjentit ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

III.2.5. Nga verifikimi i ofertës, së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme, rezulton se, ka mangësi në plotësimin e kriterit për ambjentin për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të gatimit të ushqimit, pasi, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në përputhje me pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër nuk ka paraqitur në plotë dokumentacionin sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor dhe ka mungesë fizike në dokumentacion. Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k., referuar kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë 87.3 % të punëve dhe në përputhje me këtë përqindje duhej të paraqiste edhe dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Për pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. duhet të vërtetojë që disponon ambjent për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit dhe gatimit të ushqimit, duke paraqitur dokumentacionin sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, ky operator ka mangësi fizike dokumentacioni, pasi ka paraqitur vetëm çertifikatën e pronësisë dhe aktin e miratimit higjeno sanitar, ndërkohë që në dokumentat e tenderit është kërkuar: Dokumentacionin që verteton pronësinë ose marrjen me qera të këtij ambjenti; Leje e mjedisit e tipit C, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për objektin në fjalë; Leje higjeno - sanitare për objektin në fjalë; Aktin Teknik persë i perket masave mbrojtëse të zjarrit.

Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për ambjentin nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.2.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të*

tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.2.7. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.8. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në përmbushje të kriterit kualifikues, gjykon se nuk vërtetohet fakti i disponimit të ambjentit për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e gatimit, pasi ky operator ekonomik ka dështuar të paraqesë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.11. Në dokumentat e tenderit, është përcaktuar në mënyrë të qartë që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se disponojnë një ambient për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e gatimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës në lidhje me këtë ambient, si edhe ka përcaktuar qartësisht edhe se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e një fakti të tillë.

III.2.12. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për ambientin, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër në aktin e bashkëpunimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.2.13. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuara nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA dhe operatorit ekonomik “Sori - Al” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k.,

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tyre dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur intereset e ankimesve, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA të paraqitura me shkresën e protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 752/2 prot., me objekt “Shtesë në dosjen e ankimit nr. 752, datë 13.04.2018 “Shërbimi i gatimit të ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës”, në të cilën argumentohet si më poshtë:

Referuar ankimit të Sori-al për këtë procedurë prokuruese ky ankimim nuk duhet të pranohet pasi është dorëzuar jashtë afatit 17 ditë. [...]Ka një hedhje gabim në datë të ankimit nga ana e sekretarëve të KPP pasi ankesa është dorëzuar me datë 18.04.2018 ora 13:55 ndërsa në regjistrin e ankimeve të muajit prill është: 17.04.2018. Por edhe nga kjo hedhje gabim, e datës në sistem, perseri ankesa e Sori-ai nuk mund të shqyrtohet pasi është dorëzuar jashtë afatit. Lidhur me këtë konstatim i jemi referuar dhe vendimeve për situata të ngjashme të mara nga KPP si psh, Vendim K.P.P. 311/2017 dt.16.05.2017. njoftimi I kualifikimit është bërë me datë 29.03.2018, pra nga datë 30.03.2018 dhe deri me datë 18.4.2018 janë 19 ditë, pra ankesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor dhe si e tillë nuk duhet pranuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Në lidhje me këtë dokumentacion shtesë, Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të sqarojë se asnjë dokument tjetër shtesë, përveç atij të paraqitur me formularin e ankesës së paraqitur pranë KPP-së në respekt të kushteve formale – afateve dhe respektimit të shkallëve të ankimit, nuk do të merren në konsideratë dhe shqyrtim nga ana e KPP-së, pasi referuar legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik ankimes ka pasur në dispozicion të gjithë kohën e mjaftueshme për të ngritur pretendime për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke përmbushur edhe kushtet formale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Dokumentat e reja, të paraqitura jo në kohën e duhur dhe jo me formatin e duhur të ankesës (formularin e ankesës), nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a. ka mangësi sepse: *Kontrata e Bashkëpunimit dhe Prokura e Posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dorëzohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi....”* pasi në kontratën e paraqitur në kundërshtim me sa më sipër, përveç mangësive të tjera, nuk është bërë ndarja e shërbimit përkates për secilin prej operatoreve ekonomike, por është bërë vetëm ndarja e fitimit.

Po kështu në kontratën e bashkëpunimit nuk është parashikuar neni 423 “Detyrimet Solidare” i Kodit Civil, duke mos parashikuar kështu elementin më të rëndësishëm mbrojtës të Autoritetit Kontraktor, i cili është përgjegjësia në rast mos ekzekutimit me sukses të kontratës, dhe se, Prokura e Posaçme

ku janë përcaktuar tagrat që i jepen përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomik, nuk i referohet objektit të procedurës së prokurimit REF 48682-0216-2018, të publikuar më datë 19.02.2018, me datë hapje oferte 15.03.2018. Rrjedhimisht kjo prokurë e posaçme është e pavlefshme, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, është përcaktuar:

“Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme”.

III.5.2. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.*

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik për të cilin ngrihen pretendime, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi e Përkohshme e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Nr. 1290 Rep., nr. 422/1 Kol, e lidhur në datën 13.03.2018, ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe shoqërisë “Serenissima Ristorazione” s.p.a. me objekt: “Duke qenë se, Ministria e Brendshme, në rolin e Autoritetit Kontraktor, organizon më datë 15 Mars 2018 për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës”, nga ku shoqëria “Alar Food & Service” sh.p.k. do të realizojë 15% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm, ndërsa shoqëria “Serenissima Ristorazione” s.p.a. do të realizojë 85% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm.

Konstatohet se nuk është bërë një përcaktim i elementëve apo zërave konkretë që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi në këtë kontratë.

Gjithashtu, në sistemin e prokurimeve elektronike, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi e Përkohshme e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Nr. 331 Rep., nr. 114/2 Kol, e lidhur në datën 2.01.2018, ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe shoqërisë “Serenissima Ristorazione” s.p.a. për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i gatimit dhe

Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet nga Ministria e Brendshme, nga ku shoqëria “Alar Food & Service” sh.p.k. do të realizojë 15% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm, ndërsa shoqëria “Serenissima Ristorazione” s.p.a. do të realizojë 85% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm. Bashkëlidhur kësaj kontrate është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, bashkëlidhur kësaj kontrate, me nr. 332 Rep., Nr. 115/2 Kol, datë 23.01.2018 , ku citohet se *Tagrat e dhëna nëpërmjet kësaj prokure janë të vlefshme vetëm për tenderin me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet në datën 05.02.2018, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme”.*

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ka një mungesë fizike dokumentacioni, pasi mungon dokumenti Prokurë e Posaçme, duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe përcaktimet ligjore në fuqi, në rastin kur kemi të bëjmë me bashkim operatorësh. Gjithashtu, ky fakt i mungesës së dokumentacionit është i pranuar edhe nga vetë autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorëve ekonomikë, ku shprehet (citojmë): *“Kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posaçme nuk janë realizuar sipas kërkesave të nenit 74 të VKM së 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe nuk është bërë ndarja e shërbimit përkatës për secilin prej operatorëve ekonomikë, por është bërë vetëm ndarja e fitimit. Pas verifikimit të bërë duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga të dy operatorët ekonomikë, vlerës së ofertës ekonomik të dorëzuar për këtë procedurë prokurimi si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit Neni 53 (Shqyrtimi i ofertave) ku përcaktohet se: “4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera. të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj” grupi i shqyrtimit vendosi që ta konsiderojë si devijime të vogël mangësitë e lartpërmendura në kontratë dhe prokurë.*

III.5.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k. & Serenissima Ristorazione” s.p.a., konstatohet se dokumentacioni përkatës për bashkimin e operatorëve ekonomikë, referuar edhe përcaktimeve ligjore në fuqi, ka disa mangësi dhe konkretisht: Prokura e posaçme, dokument i domosdoshëm ky i përcaktuar gjithashtu në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, mungon për kontratën me Nr. 1290 Rep., nr. 422/1 Kol, e lidhur në datën 13.03.2018, ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe shoqërisë “Serenissima Ristorazione” s.p.a. për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet në datën 15.03.2018 nga Ministria e Brendshme.

Dokumenti Prokurë e Posaçme, me nr. 332 Rep., Nr. 115/2 Kol, datë 23.01.2018 , ku citohet se *Tagrat e dhëna nëpërmjet kësaj prokure janë të vlefshme vetëm për tenderin me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet në datën 05.02.2018, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, i përket vetëm Kontratës së Bashkëpunimit të Përkohshme të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Nr. 331 Rep., nr. 114/2 Kol, e lidhur në datën 2.01.2018, ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe shoqërisë “Serenissima Ristorazione” s.p.a. për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet nga Ministria e Brendshme.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se në këtë rast, kemi të bëjmë me një mungesë fizike dokumentacioni, pasi Prokura e Posaçme e paraqitur (e vetmja) është e përcaktuar në mënyrë eksplicite që është vetëm për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datën 05.02.2018, duke përjashtuar çdo mundësi tjetër që kjo prokurë të mund të përdoret për procedura të tjera të zhvilluara apo që do të zhvillohen nga ky autoritet kontraktor. Ky fakt, duke mos përcaktuar me një dokument të posaçëm, të kërkuar në dokumentat e tenderit, si edhe në legjislacionin në fuqi, përfaqësuesin e bashkimit të operatorëve, përbën shkak që i gjithë dokumentacioni i paraqitur në emër të bashkimit, të mos ketë vlerë ligjore. Ashtu siç përcaktohet edhe në rregullat e prokurimit (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar), Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se përpara dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike.

III.5.6. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Servize” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ky bashkim nuk ka paraqitur dokumentin Prokurë e Posaçme për përcaktimin e shoqërisë që përfaqëson këtë bashkim në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Këto marrëveshje, krijohen rast pas rasti dhe nuk mundet që një prokurë me një objekt të përcaktuar, si edhe me shumë të dhëna të tjera të përcaktuara në të për një procedurë tjetër, të shërbejë si një akt i vlefshëm edhe për një procedurë tjetër të mëvoshme, pasi edhe vetë ky bashkim operatorësh krijohet rast pas rasti vetëm për qëllime të një procedure prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.5.7. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuara nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori

ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., ka mangësi pasi, anëtarët e bashkimit nuk plotësojnë numrin e të punësuarve të gatimit për periudhën e kërkuar. Listëpagesat e dorëzuara nuk janë të vulosura nga administrata tatimore, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 3.3. Kapaciteti Teknik, pikat 9, 10 e 11, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar kriteret: “Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.
- Listëpagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes me profesione si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	3
2	Mercollog/Kimist/teknolog	2
3	Ndihmes kuzhinierë/Shërbyes gatimi	15
	Total	20

- Punonjësit në tabelën e mësipërme duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune dhe të paraqesin dokumentacionin sipas profesioneve si më poshtë:

- d) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune.
- e) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune.
- f) Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes”.

III.6.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi e Përkohshme e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Nr. 1290 Rep., nr. 422/1 Kol, e lidhur në datën 13.03.2018, ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe shoqërisë “Serenissima Ristorazione” s.p.a. për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i gatimit dhe Shpërndarjes së ushqimit (katering) për Spitalin Universitar të Traumës, që do të zhvillohet në datën 15.03.2018 nga Ministria e Brendshme, nga ku shoqëria “Alar Food & Service” sh.p.k. do të realizojë 15% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm, ndërsa shoqëria

“Serenissima Ristorazione” s.p.a. do të realizojë 85% të punimeve të parashikuara në objektin e mësipërm, pa u përcaktuar/ndarë zërat dhe elementët konkretë që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi në këtë kontratë.

III.6.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

“Alar Food & Service” sh.p.k.:

- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe znj. A.B. në profesionin Banakiere, e lidhur në datën 01.12.2017, pa afat të caktuar; Librezë pune (e korrigjuar),
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z. S.S. në profesionin Transportues me motorr, e lidhur në datën 01.12.2017, pa afat të caktuar; Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe znj. Xh.T., në profesionin Ndhimës Kuzhinier, e lidhur në datën 01.05.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.Q.K. në profesionin Transportues, e lidhur në datën 29.03.2016, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe znj. H.K. në profesionin Punonjëse Pastrimi, e lidhur në datën 01.12.2015, pa afat të caktuar; Librezë Pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z. M.S. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 11.06.2015.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune; Çertifikatë për kursin në Kuzhinë;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z. E.D. në profesionin KryeKuzhinier, e lidhur në datën 11.06.2015, Dëshmi kualifikimi në kursin për Kuzhinier, Çertifikatë e notave;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z. E.B. në profesionin Kuzhinier, e lidhur në datën 01.12.2017, pa afat të caktuar; (kontratë pune në profesionin Kuzhinier e lidhur në datën 11.06.2015 me afat të pacaktuar), Librezë Pune; Dëshmi kualifikimi (e palexueshme në cilën fushë), Çertifikatë e notave;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.I.C. në profesionin Kimist, e lidhur në datën 25.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë Pune (e korrigjuar); Diplomë Bachelor në Bioteknologji,
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.E.M. në profesionin Kimist, e lidhur në datën 04.02.2018, pa afat të caktuar; Diplomë në Kimi Industriale, Librezë Pune (e korrigjuar; Vërtetim nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës për degën; Vërtetim notash,
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.F.D. në profesionin Menaxher Njësie, e lidhur në datën 12.09.2015, pa afat të caktuar; Librezë pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.A.T. në funksionin e Administratorit, e lidhur në datën 11.06.2015, pa afat të caktuar; Librezë pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.A.K. në funksionin Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, e lidhur në datën 11.06.2015, pa afat të caktuar; Librezë pune;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.U.D. në profesionin Kontabilist në prodhim ushqimor, e lidhur në datën 01.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë pune (e korrigjuar),

- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe z.E.Sh. në profesionin Kontabilist në prodhim ushqimor, e lidhur në datën 01.01.2017, pa afat të caktuar; Librezë pune,
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a;
- Listëpagesat për periudhën Janar – Dhjetor 2017, ku pasqyrohet numri i punonjësve me të dhënat përkatëse (emër, mbiemër), profesioni, etj.

“Serenissima Ristorazione” sh.p.k.

- Deklaratë për numrin e punonjësve, ku deklarohet numri 5392 njësi;
- Variacion ekonomik datë 01.01.2015, për znj. R.A. se do të bëjë pjesë në nivelin 3 Dietist Përgjegjës Shërbimi Dietic; vërtetim se ka marrë diplomë në Shkenca e Teknologji Ushqimore
- Komunikim për znj. L.G. datë 30.04.1998, se ajo do të bëjë pjesë në nivelin 2 si përgjegjëse e prodhimit të kuzhinës; Diplomë kualifikimi për shërbime hotelerie kuzhine;
- Shkresë me objekt Transformim kontrate me kohë të përcaktuar në kohë të papërcaktuar për znj. S.M.P, datë 02.04.2007; shkresë për punësim me kohë të përcaktuar datë 8.01.2007;
- Kontratë punësimi për z.B.S. datë 17.02.2003, në cilësinë e kuzhinierit; Diplomë kualifikimi për shërbime hotelerie kuzhine;
- Komunikim për z. S.L. se punësimi fillon që në datën 18.01.2010, në cilësinë e praktikantit kualifikuar si Dietist niveli 4; Diplomë në Shkenca Teknologji Ushqimore;
- Shkresë punësimi për z. M.M. datë 09.01.2012, për punësimin si praktikant kuzhinier niveli 4; komunikim se nga data 08.06.2012 kualifikohet në nivelin 4 ÇNL Turizëm; Çertifikatë pjesëmarrje në kursin për kuzhinier operator shërbimesh në kuzhinë me shpërndarje të vogël e të madhe;
- Komunikim për O.V. Datë 01.01.2001 që bën pjesë në nivelin 4 ÇNL Turizëm si kuzhinierë përgjegjëse grupi, komunikim që nga data 01.07.1998 do të jeni ndihmë kuzhinierë, shkresë punësimi me kohë të përcaktuar part-time në pozicionin punonjës në shërbimet e mensës datë 01.04.1998; Diplomë profesionale për aktivitetet teknike hotelerie;
- Shkresë punësimi datë 16.10.2017 për B.G. në pozicionin Praktikante Teknologjisë Ushqimore; Çertifikatë zëvendësuese e çertifikatës së marrjes së titullit për diplomimin pranë në kursin e studimeve në Shkenca e Teknologji Ushqimore;
- Shkresë punësimi datë 29.12.2015 për C.F., me kohë të papërcaktuar në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 18.12.2017 për G.M. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 15.02.2017 për B.E. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 23.12.2016 për B.E.B. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 15.02.2017 për B.E. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 08.06.2015 me kohë të përcaktuar për B.A. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi me kohë të përcaktuar datë 19.01.2017 për S.D. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 02.02.2017 për R.G. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 15.02.2017 për G.J. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 01.04.2017, për P.M. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 15.02.2017 për G.J. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;

- Shkresë punësimi datë 09.03.2015 për F.C. në cilësinë e punonjësit në shërbimin e mensës;
- Shkresë punësimi datë 23.12.2016 për B.M. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Shkresë punësimi datë 10.02.2015 për G.A. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Dokumenti Durc On Line, me anë të të cilit deklarohet se subjekti rezulton i rregullt përpara INPS, INAIL, CNCE;
- Deklaratë në lidhje me librezat e punës e cila nuk paraqitet për shkak se u shfuqizua në vitin 2002 me dekretin legjislativ nr. 297 (deklarohet se një tjetër instrument është librezat formative e qytetarit që i referohet personit në një konceptim më të gjerë e ka informacione, të dhëna e vërtetime që i përkasin eksperiencave të llojit edukativ, formative e të punës edhe në kuadrin social[...]), bashkëlidhur lista e ndonjë ndihmës kuzhinieri të kërkuar;
- Shkresë punësimi datë 01.06.2015 për A.M. në cilësinë e kuzhinierit të dytë;
- Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku deklarohet se operatori ekonomik Serenissima Ristorazione s.p.a. ka dorëzuar numrin mesatar të punonjësve në këtë prokurim nëpërmjet deklaratës dhe deklarën se së bashku me dokumentat përkatës posedon minimumi: 3 kuzhinierë me minimumi 1 vit eksperiencë; 2 mercellog/kimit/teknolog me minimumi 1 vit eksperiencë;
- 15 ndihmës kuzhinierë/shërbyes gatimi me minimumi 1 vit eksperiencë

III.6.4. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për numrin e punonjësve dhe konkretisht punonjësit në fushën e gatimit, pasi operatori ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k. dhe “Serenissima Ristorazione” s.p.a. nuk ka paraqitur dhe nuk plotëson numrin e punonjësve të gatimit (kuzhinier, mercellog/kimist/teknolog, ndihmës kuzhine/shërbyes gatimi), sipas përqindjes së tij të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, duke shqyrtuar edhe listëpagesat e paraqitura për periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit, rezulton se, ky i fundit, nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit me të gjithë dokumentat e kërkuara në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Numri i punonjësve në fushën e gatimit të paraqitur nga secila shoqëri pjesëtare e bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të realizuar këtë kontratë, në përputhje dhe përpjesëtim me përqindjen e marrë përsipër, nuk arrin të jetë sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Pra pavarësisht se është paraqitur një numër i caktuar punonjësish, që në pamje të parë duket i plotësuar vetëm për nga ana numerike pa verifikuar dokumentacionin shoqëruar apo profesionin, por që në shqyrtim në brendësi në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, ka mangësi, pasi nuk ka paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dokumentacionin specifik: kontratat pune, librezat pune dhe diploma ose çertifikata kualifikimi sipas profesioneve, si edhe nuk plotëson numrin e tyre për profesionet kuzhinier (me gjithë dokumentacionin e duhur – kontratë pune, diplomë ose çertifikatë kualifikimi, librezë pune), mercellog/kimist/teknolog, apo ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi referuar kjo listëpagesat. Nga ana tjetër, konstatohet se operatori ekonomik “Serenissima Ristorazione” s.p.a. nuk ka paraqitur asnjë dokument listëpagese apo të ngjashme me të, për verifikimin nëse punonjësit e deklaruar prej saj janë pjesë e shoqërisë, për periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, duke marrë në konsideratë vetëm dokumentacionin për punonjësit, për të cilët është i plotë sipas të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor, pra është i shoqëruar me kontratë pune, librezë pune ose diplomë / çertifikatë kualifikimi,

në varësi të profesionit të kërkuar, për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, asnjë nga operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serinissima Ristorazione” s.p.a. nuk plotëson numrin e punonjësve në fushën e gatimit.

Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për numrin e punonjësve nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.6.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi... ”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.6.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.6.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serinissima Ristorazione” s.p.a., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga asnjëri prej operatorëve ekonomikë nuk plotësohet kërkesa për numrin e punonjësve në fushën e gatimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me

kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.6.8. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Sori - Al” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” SPA, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interes e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-48682-02-16-2018, me objekt “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 134.814.264 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Brendshme.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sori - Al” sh.p.k., për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & “Serenissima Ristorazione” s.p.a. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sori - Al” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 752 Protokolli

Datë 13.04.2018

Nr. 777 protokolli

Datë 18.04.2018



Kryetar
Evis Shurdha